



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE
Drejtoria e Subjekteve Zgjedhore, Mbikëqyrjes, Financimit dhe
Monitorimit

Data	
Nr.	Prot.

RELACION

PËR

PROJEKTVENDIMIN

PËR

“MIRATIMIN E RAPORTIT TË GJETJEVE NGA AUDITIMI I FONDEVE TË PËRFITUARA DHE SHPENZUARA NGA PARTITË POLITIKE PJESËMARRËSE NË ZGJEDHJET E PJESHME VENDORE, TË DATËS 6 MARS 2022”

I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJSLACIONIN NË FUQI

Neni 19, pikat 1, shkronja “ë” dhe “n” e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ka parashikuar kompetencën e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për të monitoruar nëpërmjet administratës së KQZ-së apo subjekteve të kontraktuara fushatën zgjedhore, të gjitha aspektet e financimit të fushatës zgjedhore, pasqyrimin e fushatës në media, si dhe për të ushtruar në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia nje shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Neni 21, pika 1 shkronja “dh”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ka parashikuar se me kërkesë të Komisionerit, Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve vendos sanksione administrative kundër personave apo subjekteve zgjedhore dhe/ose kandidatëve të tyre, që kryejnë kundërvajtje administrative në lidhje me zgjedhjet.

Neni 84 pikat 5, 6 e 9, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, përcaktojnë kohën e përgjithshme të transmetimit të reklamave politike gjatë fushatës zgjedhore e cila nuk mund të jetë më shumë se 90 minuta për secilën parti të regjistruar në zgjedhje, radiot dhe televizionet private kombëtare dhe satelitore, të cilat pranojnë reklama me pagesë, detyrohen që gjysmën e kohës totale të reklamës t’ua vë në dispozicion falas subjekteve zgjedhore, si dhe kohën e përgjithshme të transmetimit të reklamave që i vihet në dispozicion nga ana e radiove

dhe televizioneve private partive joparlamentare dhe kandidatëve të propozuar nga zgjedhësit, e cila nuk mund të jetë më shumë se 100 minuta.

Neni 88, pika 7, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, përcakton se në rast se shuma e shpërndarë si paradhënie partive politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 prill 2021, është më e lartë se totali i shpenzimeve të fushatës zgjedhore të raportuara nga partia politike ose është vlerësuar si e tillë nga KQZ-ja sipas auditimeve të pavarura, atëherë partia politike është e detyruar të kthejë diferencën në KQZ.

Neni 90, pikat 3 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikon se subjektet zgjedhore duhet të marrin masa për koordinimin e informacionit nga kandidatët e tyre, si dhe mbajnë përgjegjësi për shkeljen e kushteve dhe detyrimeve lidhur me financimin nga ana e kandidatëve të vet, me përjashtim të rastit kur vërtetohet se subjekti zgjedhor nuk ka pasur mundësi, ose me të gjitha përpjekjet e bëra nuk ka arritur dot të parandalojë shkeljen e kryer nga kandidati.

Neni 92/2 pika 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, përcakton se shuma e shpenzimeve të bëra nga një subjekt zgjedhor, përfshirë kandidatët e tij, për një fushatë zgjedhore nuk duhet të jetë më shumë se 3 herë më e madhe se shuma më e lartë që ka marrë një subjekt politik nga fondet publike për qëllime zgjedhore.

Neni 92/3, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, përcakton afatet e dorëzimit të raporteve financiare të fushatës zgjedhore si dhe mënyrën e raportimit.

Nenet 92/6 dhe 92/7, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, përcaktojnë mënyrën e auditimit të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga subjektet zgjedhore gjatë fushatës zgjedhore, si dhe mënyrën e përzgjedhjes së tyre.

Vendimi nr. 9, datë 29.1.2022, të Komisionit Rregullator, “Për përcaktimin e rregullave për raportimin financiar të partive politike/subjekteve zgjedhore, kontrollin dhe verifikimin e financimeve dhe shpenzimeve të tyre gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”, përcakton mënyrën se si subjektet zgjedhore duhet të raportojnë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Në zbatim neneve 19, pika 1, shkronjat “ë” e “n” dhe pika 2, 21 pika 1, shkronja “dh”, 78, 84 pikat 5 e 8, 88 pika 7, 90 pikat 3 e 4, 92/2, pika 4, 92/3, 92/6, 92/7, 171 pika 1, 173 pikat 1, 3, 5, 8 e 9, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimeve nr. 9, datë 29.1.2022, të Komisionit Rregullator, “Për përcaktimin e rregullave për raportimin financiar të partive politike/subjekteve zgjedhore, kontrollin dhe verifikimin e financimeve dhe shpenzimeve të tyre gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore” dhe nr. 26 datë 17.03.2022, “Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve të pjesshme për kryetar në

bashkitë Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnjë, të datës 6 mars 2022”, të Komisionit Rregullator, si dhe raportit të gjetjeve nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet e pjesshme vendore, të datës 6 mars 2022”, është hartuar projektvendimi “Për miratimin e raportit të gjetjeve nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet e pjesshme vendore, të datës 6 mars 2022”.

II. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTVENDIMIT

Më 6 mars 2022 u zhvilluan zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie në 6 bashki. Në këto zgjedhje u regjistruan 5 (pesë) subjekte zgjedhore, nga të cilët 3 (tre) parti politike: Partia Socialiste e Shqipërisë, Partia Demokratike, Partia Lëvizja e Re dhe koalicioni Shtëpia e Lirisë i përbërë nga 2 (dy) parti politike, Partia Lëvizja Socialiste për Integrim (sot Partia e Lirisë) dhe Partia Demokristiane.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me datë 27.01.2022 caktoi 20 (njëzet) monitorues për monitorimin e fushatës zgjedhore, të cilët çdo 10 (dhjetë) ditë nga momenti i nënshkrimit të kontratës dorëzonin raportet e ndërmjetme në KQZ, si dhe 7 (shtatë) ditë pas përfundimit të zgjedhjeve dorëzuan raportin përfundimtar.

Për periudhën Shkurt 2022 deri më 13 mars 2022 janë administruar 60 (gjashtëdhjetë) raporte monitorimi nga 20 (njëzet) monitoruesit e caktuar, si dhe 7 (shtatë) raporte shkeljesh për të cilat është marrë vendim nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Pas vendimit nr. 26 datë 17.03.2022, “Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve të pjesshme për kryetar në bashkitë Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnjë, të datës 6 mars 2022”, KQZ u dërgojë shkresë për rikujtim të detyrimit ligjor për dorëzimin e raporteve financiare të fushatës zgjedhore të gjitha subjekteve zgjedhore pjesëmarrëse në zgjedhjet e datës 6 mars 2022, duke ju referuar nenit 92/3, pika 1, të Kodit Zgjedhor.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve administroi 5 (pesë) raporte financiare të fushatës zgjedhore të dorëzuara nga subjektet zgjedhore.

Në total gjatë fushatës zgjedhore 5 (pesë) subjektet zgjedhore kanë shpenzuar 32.877.889,3 (tridhjetë e dy milion e tetëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e nëntë presje tre) lekë.

Financimet jo publike për 5 (pesë) subjektet zgjedhore kanë qenë në total 32.897.000,45 (tridhjetë e dy milion e tetëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë presje dyzet e pesë) lekë.

Pas dorëzimit të raporteve financiare nga vetë subjektet zgjedhore, KQZ caktoi ekspertët kontabël të licensuar (auditues ligjor) për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike për fushatën zgjedhore me vendimin nr. 138, datë 18.3.2022, “Për shpalljen e rezultatit të shortit për emërimin e ekspertëve kontabël të licensuar (audituesit ligjor), të cilët do të kryejnë auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga subjektet zgjedhor, si dhe kandidatët për kryetar bashkie, për fushatën zgjedhore për zgjedhjet e pjesshme vendore, të datës 6 mars 2022”.

Ekspertët kontabël të licensuar (auditues ligjor) të përzgjedhur, referuar afateve të auditimit të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga subjektet zgjedhore për fushatën zgjedhore, të datës 6 mars 2022, të përcaktuara në kontratën e lidhur me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, depozituan raportet e auditimit për 5 (pesë) subjekte zgjedhore që morën pjesë në zgjedhje.

Pas administrimit të raporteve të sipërcituara KQZ evidentoi mospërputhje në lidhje me Kodin Zgjedhor si dhe aktet nënligjore për partitë politike si më poshtë vijon:

- Mosdorëzim i raporteve financiare nga kandidatët e listave shumëmemërore;
- Mungese e dokumentave justifikuese mbi shpenzimet e kryera gjatë fushatës nga subjektet zgjedhore;
- Mosbërja transparente e burimeve të financimit;
- Pranimi i dhurimeve me vlerë më të madhe se 50 mijë lekë jo nëpërmjet llogarisë bankare të deklaruar;
- Mosbashkëpunim me KQZ duke mos i kthyer përgjigje kërkesave të saj.

Gjithashtu u evidentuan mospërputhje për reklamat politike në media, si më poshtë vijon:

- Tejkalim i 90 minutave të lejuara sipas nenit 84 pika 5 e Kodit Zgjedhor nga OSHMA-të;
- Mosdorëzimi i tarifave zyrtare nga OSHMA-të në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve sipas dispozitave të Kodit Zgjedhor të cilat kanë transmetuar reklama politike;
- Mosbashkëpunim me KQZ duke mos i kthyer përgjigje kërkesave të saj.

Në seancën pulike të datës 6 Tetor 2023 në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, organizata KRIIK ka depozituar rekomandime shtesë lidhur me Projektvendimin. Rekomandimet e KRIIK u morën në shqyrtim dhe pas verifikimeve përkatëse rezultoi:

- Partia Socialiste e Shqipërisë dhe Partia Demokratike e Shqipërisë nuk kanë deklaruar të gjitha zyrat zgjedhore të hapura për fushatë zgjedhore, gjë e cila është vërtetuar dhe nga raportet e monitoruesve të fushatës zgjedhore.
- Kandidatja e subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, zj. Emirjana Sako, kandidati i subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, z. Edison Memolla, kandidati i subjektit zgjedhor, koalicioni “Shtëpia e Lirisë”, z. Ardian Muka si dhe kandidati i subjektit zgjedhor, koalicioni “Shtëpia e Lirisë”, z. Bardh Spahia i kanë dhuruar vetes vlerë më të madhe se 50 mijë lekë cash dhe jo nëpërmjet llogarisë së posaçme bankare.

Ky projekt-vendimi është përcaktimi i masave administrative për subjektet zgjedhore të cilët kanë shkelur rregullat dhe formatet e standardizuara të miratuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, si dhe përcaktimi i masave administrative për OSHMA-të që kanë shkelur detyrimet e Kodit Zgjedhor.

Për sa më lart, në këtë relacion, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, brenda kompetencave të veta dhe

në respektim të detyrimeve e afateve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, shqyrton dhe miraton projektvendimit “Për miratimin e raportit të gjetjeve nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet e pjesshme vendore, të datës 6 mars 2022”.

Valbona BALLGJINI - Drejtorja e Subjekteve Zgjedhore, Mbikëqyrjes, Financimit dhe Monitorimit

Majlinda CELMETA - Drejtor i Përgjithshëm, Drejtorja e Përgjithshme e Administrimit të Zgjedhjeve

Ylli MERKAJ - Sekretar i Përgjithshëm



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: DD MM VVVV

Nr: 000-000

Ora: HH:MM

PROJEKTVENDIM

PËR

MIRATIMIN E RAPORTIT TË GJETJEVE NGA AUDITIMI I FONDEVE TË PËRFITUARA DHE SHPENZUARA NGA PARTITË POLITIKE PJESËMARRËSE NË ZGJEDHJET E PJESSHME VENDORE, TË DATËS 6 MARS 2022

Në mbështetje të neneve 19, pika 1, shkronjat “ë” e “n” dhe pika 2, 21 pika 1, shkronja “dh”, 78, 84 pikat 5 e 8, 88 pika 7, 90 pikat 3 e 4, 92/2, pika 4, 92/3, 92/6, 92/7, 171 pika 1, 173 pikat 1, 3, 5, 8 e 9, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimeve nr. 9, datë 29.1.2022, të Komisionit Rregullator, “Për përcaktimin e rregullave për raportimin financiar të partive politike/subjekteve zgjedhore, kontrollin dhe verifikimin e financimeve dhe shpenzimeve të tyre gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”, nr. 26, datë 17.3.2022, të Komisionit Rregullator “Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve të pjesshme për kryetar në bashkitë Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnjë, të datës 6 Mars 2022”, si dhe raportit të gjetjeve nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet e pjesshme vendore, të datës 6 Mars 2022, bashkëlidhur,

V E N D O S:

1. Miratimin e gjetjeve të raportit të auditimit të fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet e pjesshme vendore, të datës 6 Mars 2022, sipas shtojcës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. T’i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për partinë politike “Partia Socialiste e Shqipërisë”, me gjorbë në vlerën 2 000 000 deri në 5 000 000 lekë, sipas nenit 23/4, pika 3 të ligjit “Për Partitë Politike”.
3. T’i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për

Data: dd mm vvvv Nr: 123-456
Ora: hh:mm



“Për miratimin e raportit të gjetjeve nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet e pjesshme vendore, të datës 6 Mars 2022”

partinë politike “Partia Demokratike”, me gjobë në vlerën 2 000 000 deri në 5 000 000 lekë, sipas nenit 23/4, pika 3 të ligjit “Për Partitë Politike”.

4. T’i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për partinë politike “Partia Demokratike”, me gjobë në vlerën 500 000 deri në 1 000 000 lekë, sipas nenit 173, pika 3 të Kodit Zgjedhor.
5. T’i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për partinë politike “Partia Demokratike”, me gjobë në vlerën 100 000 deri në 3 000 000 lekë, sipas nenit 173, pika 8 të Kodit Zgjedhor.
6. T’i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për kandidaten për kryetare bashkie të Partisë Socialiste e Shqipërisë, zj. Emirjana Sako, sipas nenit 173, pika 5 të Kodit Zgjedhor.
7. T’i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për kandidatin për kryetar bashkie të Partisë Socialiste e Shqipërisë, z. Edison Memolla, sipas nenit 173, pika 5 të Kodit Zgjedhor.
8. T’i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për kandidatin për kryetar bashkie të Koalicionit Shtëpia e Lirisë, z. Bardh Spahia, sipas nenit 173, pika 5 të Kodit Zgjedhor.
9. T’i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për kandidatin për kryetar bashkie të Koalicionit Shtëpia e Lirisë, z. Ardian Muka, sipas nenit 173, pika 5 të Kodit Zgjedhor.
10. Marrjen e masës administrative me gjobë në masën 3 000 deri në 90 000 lekë për Ofruesin e Shërbimit Mediatik Audioviziv (OSHMA) ADTN, sipas neneve 84, pika 5, dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor.
11. Marrjen e masës administrative me gjobë në masën 3 000 deri në 90 000 lekë për Ofruesin e Shërbimit Mediatik Audioviziv (OSHMA) ABEG Tv, sipas neneve 84, pika 5, dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor.
12. Marrjen e masës administrative me gjobë në masën 3 000 deri në 90 000 lekë për Ofruesin e Shërbimit Mediatik Audioviziv (OSHMA) Club Tv , sipas neneve 84, pika 5, dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor.
13. Marrjen e masës administrative me gjobë në masën 3 000 deri në 90 000 lekë për Ofruesin e Shërbimit Mediatik Audioviziv (OSHMA) Era Digitalb , sipas neneve 84, pika 5, dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor.
14. Marrjen e masës administrative me gjobë në masën 3 000 deri në 90 000 lekë për Ofruesin e Shërbimit Mediatik Audioviziv (OSHMA) Glob Tv , sipas neneve 84, pika 5, dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor.
15. Marrjen e masës administrative me gjobë në masën 3 000 deri në 90 000 lekë për Ofruesin e Shërbimit Mediatik Audioviziv (OSHMA) One Tv Vlora , sipas neneve 84, pika 5, dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor.

16. Marrjen e masës administrative me gjobë në masën 3 000 deri në 90 000 lekë për Ofruesin e Shërbimit Mediatik Audioviziv (OSHMA) Shijak Tv , sipas neneve 84, pika 5, dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor.
17. Marrjen e masës administrative me gjobë në masën 3 000 deri në 90 000 lekë për Ofruesin e Shërbimit Mediatik Audioviziv (OSHMA) Tv BS , sipas neneve 84, pika 5, dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor.
18. Marrjen e masës administrative me gjobë në masën 3 000 deri në 90 000 lekë për Ofruesin e Shërbimit Mediatik Audioviziv (OSHMA) Tv 6+1 , sipas neneve 84, pika 5, dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor.
19. Marrjen e masës administrative me gjobë në masën 3 000 deri në 90 000 lekë për Ofruesin e Shërbimit Mediatik Audioviziv (OSHMA) Tv Antena Nord , sipas neneve 84, pika 5, dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor.
20. Marrjen e masës administrative me gjobë në masën 3 000 deri në 90 000 lekë për Ofruesin e Shërbimit Mediatik Audioviziv (OSHMA) Tv Berati , sipas neneve 84, pika 5, dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor.
21. Marrjen e masës administrative me gjobë në masën 3 000 deri në 90 000 lekë për Ofruesin e Shërbimit Mediatik Audioviziv (OSHMA) Tv Channel 1 , sipas neneve 84, pika 5, dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor.
22. Marrjen e masës administrative me gjobë në masën 3 000 deri në 90 000 lekë për Ofruesin e Shërbimit Mediatik Audioviziv (OSHMA) Tv Channel 7 , sipas neneve 84, pika 5, dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor.
23. Marrjen e masës administrative me gjobë në masën 3 000 deri në 90 000 lekë për Ofruesin e Shërbimit Mediatik Audioviziv (OSHMA) Tv Jug , sipas neneve 84, pika 5, dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor.
24. Marrjen e masës administrative me gjobë në masën 3 000 deri në 90 000 lekë për Ofruesin e Shërbimit Mediatik Audioviziv (OSHMA) Tv Klaudiana , sipas neneve 84, pika 5, dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor.
25. Marrjen e masës administrative me gjobë në masën 3 000 deri në 90 000 lekë për Ofruesin e Shërbimit Mediatik Audioviziv (OSHMA) Tv Kopliku , sipas neneve 84, pika 5, dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor.
26. Marrjen e masës administrative me gjobë në masën 3 000 deri në 90 000 lekë për Ofruesin e Shërbimit Mediatik Audioviziv (OSHMA) Tv Lobi , sipas neneve 84, pika 5, dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor.
27. Marrjen e masës administrative me gjobë në masën 3 000 deri në 90 000 lekë për Ofruesin e Shërbimit Mediatik Audioviziv (OSHMA) Tv Mati , sipas neneve 84, pika 5, dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor.
28. Marrjen e masës administrative me gjobë në masën 3 000 deri në 90 000 lekë për Ofruesin e Shërbimit Mediatik Audioviziv (OSHMA) Tv Premium Channel, sipas neneve 84, pika 5, dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor.

29. Marrjen e masës administrative me gjobë në masën 3 000 deri në 90 000 lekë për Ofruesin e Shërbimit Mediatik Audioviziv (OSHMA) Tv Rozafa Motiv, sipas neneve 84, pika 5, dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor.
30. Marrjen e masës administrative me gjobë në masën 3 000 deri në 90 000 lekë për Ofruesin e Shërbimit Mediatik Audioviziv (OSHMA) Tv Saranda, sipas neneve 84, pika 5, dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor.
31. Marrjen e masës administrative me gjobë në masën 3 000 deri në 90 000 lekë për Ofruesin e Shërbimit Mediatik Audioviziv (OSHMA) Tv Sot 7, sipas neneve 84, pika 5, dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor.
32. Marrjen e masës administrative me gjobë në masën 3 000 deri në 90 000 lekë për Ofruesin e Shërbimit Mediatik Audioviziv (OSHMA) Tv Star Plus, sipas neneve 84, pika 5, dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor.
33. Marrjen e masës administrative me gjobë në masën 3 000 deri në 90 000 lekë për Ofruesin e Shërbimit Mediatik Audioviziv (OSHMA) Tv UTV Education, sipas neneve 84, pika 5, dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor.
34. Marrjen e masës administrative me gjobë në masën 3 000 deri në 90 000 lekë për Ofruesin e Shërbimit Mediatik Audioviziv (OSHMA) TVT, sipas neneve 84, pika 5, dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor.
35. Marrjen e masës administrative me gjobë në masën 3 000 deri në 90 000 lekë për Ofruesin e Shërbimit Mediatik Audioviziv (OSHMA) Tv Re.AL , sipas neneve 84, pika 5, dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor.
36. Marrjen e masës administrative me gjobë në masën 3 000 deri në 90 000 lekë për Ofruesin e Shërbimit Mediatik Audioviziv (OSHMA) Syri TV , sipas neneve 84, pika 5, dhe 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor.
37. Marrjen e masës administrative me gjobë në masën 100 000 deri në 3 000 000 lekë për Ofruesin e Shërbimit Mediatik Audioviziv (OSHMA) Top Channel, sipas neneve 92/6, pika 6, dhe 173, pika 8 të Kodit Zgjedhor.
38. Marrjen e masës administrative me gjobë në masën 100 000 deri në 3 000 000 lekë për Ofruesin e Shërbimit Mediatik Audioviziv (OSHMA) Syri Tv, sipas neneve 92/6, pika 6, dhe 173, pika 8 të Kodit Zgjedhor .
39. Marrjen e masës administrative me gjobë në masën 100 000 deri në 3 000 000 lekë për Ofruesin e Shërbimit Mediatik Audioviziv (OSHMA) Star Plus, sipas neneve 92/6, pika 6, dhe 173, pika 8 të Kodit Zgjedhor .
40. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
41. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: dd mm vvvv Nr: 123-456
Ora: hh:mm





KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE
Drejtoria e Subjekteve Zgjedhore, Mbikëqyrjes, Financimit dhe
Monitorimit

Data	
Nr.	Prot.

Shtojca nr. 1

RAPORTI I GJETJEVE NGA AUDITIMI I FONDEVE TË PËRFITUARA DHE SHPENZUARA NGA
PARTITË POLITIKE PJESËMARRËSE NË ZGJEDHJET E PJESHME VENDORE, TË DATËS 6 MARS
2022

I. Të përgjithshme

Më 6 Mars 2022 u zhvilluan zgjedhjet e pjesshme vendore për Kryetar Bashkie në 6 bashki të vendit, përkatësisht Durrës, Shkodër, Rrogozhinë, Lushnje, Dibër dhe Vorë. Në këto zgjedhje u regjistruan 5 (pesë) subjekte zgjedhore, nga të cilët 3 (tre) parti politike: Partia Socialiste e Shqipërisë, Partia Demokratike, Partia Lëvizja e Re dhe koalicioni Shtëpia e Lirisë i përbërë nga 2 (dy) parti politike, Partia Lëvizja Socialiste për Integrim (sot Partia e Lirisë) dhe Partia Demokristiane.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me datë 27.01.2022 caktoi monitoruesit e fushatës zgjedhore, të cilët çdo 10 (dhjetë) ditë nga momenti i nënshkrimit të kontratës dorëzonin raportet e ndërmjetme në KQZ, si dhe 7 (shtatë) ditë pas përfundimit të zgjedhjeve dorëzuan raportin përfundimtar. Në zbatim të vendimit nr. 2, datë 21.01.2022, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, "Për caktimin e numrit të monitoruesve për zgjedhjet e pjesshme për organet e qeverisjes vendore të datës 6.3.2022", si dhe të urdhrit nr. 117 datë 26.02.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve "Për miratimin e kontratës tip të shërbimit për monitorimin e partive politike, subjekteve zgjedhore, kandidatëve të tyre dhe institucioneve publike", Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka miratuar një liste me 20 (njëzet) monitorues për 6 bashki.

Për periudhën Shkurt 2022 deri më 13 Mars 2022 janë administruar 60 (gjashtëdhjetë) raporte monitorimi nga 20 (njëzet) monitoruesit e caktuar nga KQZ, si dhe 7 (shtatë) raporte shkeljesh për të cilat është marrë vendim nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Referuar nenit 86 të Kodit Zgjedhor burimet e financimit të fushatës për subjektet zgjedhore janë:

- a. fondet e dhëna paradhënie nga Buxheti i Shtetit për partitë politike të regjistruara si subjekte zgjedhore,
- b. të ardhurat e vetë subjektit zgjedhor të krijuara sipas ligjit,
- c. dhuratat për subjektin zgjedhor dhe kandidatët e tij, në vlerë monetare, natyrë ose shërbime të dhëna, sipas nenit 92/1 të Kodit Zgjedhor,
- d. huat ose kreditë e marra nga partitë politike ose kandidatët e tyre sipas ligjit. Në asnjë rast vlera e një huaje ose kredie nuk duhet të kalojë shumën e fondeve, sipas pikës 2 të nenit 92/1 të Kodit Zgjedhor.

Nga raportet financiare të subjekteve zgjedhore të administruara në KQZ rezulton se subjektet zgjedhore pjesëmarrëse në zgjedhje, patën të ardhura dhe shpenzime për qëllim të fushatës zgjedhore si më poshtë vijon:

	Subjektet Zgjedhore	Totali i shpenzimeve /lekë	Të ardhurat totale/lekë
1	Partia Socialiste e Shqipërisë	5.584.191,45	5.603.302,60
2	Partia Demokratike	13.484.202,95	13.484.202,95
3	Lëvizja e Re	30.000	30.000
4	Partia Lëvizja Socialiste për Integrim	13.779.494,90	13.779.494,90
5	Partia Demokristiane e Shqipërisë	0	0

Në zbatim të neneve 78, 84 pikat 5 e 9, 88 pika 7, 90 pikat 3 e 4, 92/1, 92/2 pika 4, 92/3, 92/6 dhe 92/7, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, subjektet zgjedhore që garojnë në zgjedhje kanë detyrimin të bëjnë transparente fondet e përfituara dhe të shpenzuara gjatë fushatës zgjedhore.

Referuar nenit 92/3, pika 1, të Kodit Zgjedhor, 60 ditë pas shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve, subjektet zgjedhore kanë detyrimin ligjor të dorëzojnë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve raportet financiare të fushatës zgjedhore përfshirë dhe raportet e kandidatëve. Raportet financiare përmbajnë të dhënat e detajuara mbi:

1. Të ardhura:

- a. Financime publike
- b. Financime jopublike
 - b.1 Të ardhura monetare

b.2 Të ardhura, dhurime në natyrë

b.3 Të ardhura të krijuara nga vetë subjekti

2. Huatë dhe Kreditë

3. Shpenzimet e partisë/kandidatit të propozuar nga zgjedhësit

4. Raportet e kandidatëve

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pas përfundimit të procesit zgjedhor për zgjedhjet e pjesshme vendore, të datës 6 Mars 2022, në zbatim të nenit 92/6 dhe vendimit nr. 138, datë 18.3.2022, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për shpalljen e rezultatit të shortit për emërimin e ekspertëve kontabël të licensuar (audituesit ligjor), të cilët do të kryejnë auditimin e fondeve të përftuara dhe të shpenzuara nga subjektet zgjedhor, si dhe kandidatët për Kryetar Bashkie, për fushatën zgjedhore për zgjedhjet e pjesshme vendore, të datës 6 Mars 2022”, caktoi ekspertët kontabël të licensuar (auditues ligjor) për auditimin e fondeve të përftuara dhe shpenzuara nga partitë politike për fushatën zgjedhore.

Aplikuan dhe u përzgjedhën 3 (tre) ekspertë kontabël të licensuar (auditues ligjor). Pas përzgjedhjes së tyre u lidhën kontratat me 3 (tre) auditueset ligjore, të cilat brenda 30 (tridhjetë) ditëve duhet të dorëzonin raportet e auditimit në KQZ. Për 2 (dy) audituese ligjore ka pasur shtyrje të afatit 30 (tridhjetë) ditë me kërkesë të tyre.

Ekspertët kontabël të licensuar (auditues ligjor), referuar afateve kontraktuale të lidhura me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, depozituan raportet e auditimit për 5 (pesë) subjektet zgjedhore që morën pjesë në zgjedhje.

II. Auditimi i raporteve financiare

Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve u dorëzuan 5 (pesë) raporte auditimi nga audituesit ligjor.

Nga audituesit u shprehën opinione me rezerva për:

1. Partinë Socialiste të Shqipërisë e audituar nga zj. Silvana Gjikhima, e cila ka konstatuar se kandidatja për Kryetar Bashkie e Qarkut Durrës nuk ka hapur llogari bankare të posaçme për fushatën zgjedhore, likuidimet janë bërë cash, si dhe në shpenzimet e kandidatëve kishte raste ku shpenzimet nuk ishin me faturë tatimore, por vetëm me kupon tatimor ose e anasjellta ishte lëshuar fature tatimore por mungonte kuponi.
2. Partinë Demokratike e audituar nga zj. Silvana Gjikhima, e cila ka konstatuar se partia nuk ka hapur një llogari të posaçme për fushatën, nuk janë paraqitur të ardhura dhe shpenzime për degët e partisë, si dhe nuk janë paraqitur të ardhurat dhe shpenzimet për kandidatët për Kryetar Bashkie.

II.1 Shqyrtimi i raporteve financiare nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të dorëzuara nga monitoruesit, subjektet zgjedhore dhe ekspertët kontabël të licensuar

Nga raportet e auditimit të ekspertëve kontabël të licensuar si dhe raportet e monitoruesve, raporte të cilat kanë qenë dhe janë publike në faqen zyrtare të KQZ, si dhe konstatime të organizatës Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK), rezulton se:

1. Partia Socialiste e Shqipërisë nga verifikimet e bëra me raportet e monitoruesve të caktuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për monitorimin e fushatës zgjedhore rezulton se ka pasur në funksion 36 (tridhjetë e gjashtë) zyra zgjedhore si më poshtë vijon:
 - 7 zyra zgjedhore në bashkinë Shkodër nga të cilat 2 zyra zgjedhore në njësitë administrative Velipojë, Berdice, Dajç dhe Ana e Malit, 2 zyra zgjedhore në ZAZ nr. 3, 1 zyrë zgjedhore në ZAZ nr. 4, 1 zyrë zgjedhore në ZAZ nr. 5, si dhe 1 zyrë zgjedhore në njësinë administrative Gur i Zi, Postrisë, Pult, Rrethina, Shalë dhe Shosh.
 - 21 zyra zgjedhore në bashkinë Durrës nga të cilat 6 zyra zgjedhore në lagjet nr. 1, 2, 3 dhe 4, 5 zyra zgjedhore në lagjet nr. 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11 dhe 12, 3 zyra zgjedhore në lagjen nr. 13, 2 zyra zgjedhore në njësinë administrative Shkozë, 2 zyra zgjedhore në njësinë administrative Sukth, Maminas, si dhe 3 zyra zgjedhore në njësinë administrative Katund i Ri, Rashbull, Manës.
 - 3 zyra zgjedhore në bashkinë Lushnjë nga të cilat 1 zyrë zgjedhore në njësinë administrative Lushnjë Rajoni 2, 1 zyrë zgjedhore në Ballagat, si dhe 1 zyrë zgjedhore në Lushnjë Qendër.
 - 2 zyra zgjedhore në bashkinë Rrogozhinë nga të cilat 1 zyrë zgjedhore në lagjen nr. 1, si dhe 1 zyrë zgjedhore në rrugën Çamëria, Gose e Madhe.
 - 1 zyrë zgjedhore në bashkinë Vorë.
 - 2 zyra zgjedhore në bashkinë Dibër nga të cilat 1 zyrë zgjedhore në Peshkopi dhe 1 zyrë zgjedhore në Maqellar.

Tek raportet e dorëzuara në KQZ partia Socialiste e Shqipërisë ka deklaruar vetëm 21 (njëzet e një) zyra zgjedhore. Gjithashtu lidhur me shpenzimet për mediat sociale partia ka deklaruar se ka shpenzuar 39 600 (tridhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind) lekë, si dhe kandidatja për kryetare

Bashkie e Bashkisë Durrës ka shpenzuar 14 795 (katërbëdhjetë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e pesë) lekë, por nga verifikimet e bëra në historikun e mediave sociale (facebook) rezulton se:

- Kandidati i Dibrës ka shpenzuar 16 386 (gjashtëmbëdhjetë mijë e treqind e tetëdhjetë e gjashtë) lekë;
- Kandidati i Lushnjes ka shpenzuar 14 867 (katërbëdhjetë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë;
- Kandidati i Rrogozhinës ka shpenzuar 14 867 (katërbëdhjetë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë;
- Kandidati i Vorës ka shpenzuar 13 022 (trembëdhjetë mijë e njëzet e dy) lekë;
- Kandidatja e Durrësit ka shpenzuar 33 098 (tridhjetë e tre mijë e nëntëdhjetë e tetë) lekë;
- Kandidatja e Shkodrës ka shpenzuar 44 601 (dyzet e katër mijë e gjashtëqind e një) lekë

Në total për mediat sociale nga kandidatët për kryetar bashkie të Partisë Socialiste e Shqipërisë janë shpenzuar 136 841 (njëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e dyzet e një) lekë.

2. Partia Lëvizja Socialiste për Integrim nga verifikimet e bëra mbi shpenzimet për mediat sociale ka deklaruar se kandidati për kryetar bashkie i bashkisë Durrësit ka shpenzuar 94 641, 56 (nëntëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e dyzet e një presje pesëdhjetë e gjashtë) lekë, por nga verifikimet e bëra në historikun e mediave sociale (facebook) rezulton se:

- Kandidati i Durrësit ka shpenzuar 163 431 (njëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e katërqind e tridhjetë e një) lekë;
- Kandidati i Shkodrës ka shpenzuar 92 242 (nëntëdhjetë e dy mijë e dyqind e dyzet e dy) lekë

Në total për mediat sociale nga kandidatët për kryetar bashkie të Koalicionit “Shtëpia e Lirisë” janë shpenzuar 255 673 (dyqind e pesëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e tre) lekë.

3. Partia Demokratike nga verifikimet e bëra me raportet e monitoruesve të caktuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për monitorimin e fushatës zgjedhore rezulton se ka pasur në funksion 33 (tridhjetë e tre) zyra zgjedhore si më poshtë vijon:

- 11 zyra zgjedhore në bashkinë Shkodër nga të cilat 3 zyra zgjedhore në njësinë

administrative Velipojë, Berdise, Dajç dhe Ana e Malit, 3 zyra zgjedhore në ZAZ nr. 31
1 zyrë zgjedhore në ZAZ nr. 4, 2 zyra zgjedhore në ZAZ nr. 5, si dhe 2 zyra zgjedhore në
njësinë administrative Gur i Zi, Postrisë, Pult, Rrethina, Shalë dhe Shosh.

- 13 zyra zgjedhore në bashkinë Durrës nga të cilat 2 zyra zgjedhore në lagjet nr. 1, 2, 3
dhe 4, 4 zyra zgjedhore në lagjet nr. 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11 dhe 12, 2 zyra zgjedhore në
lagjen nr. 13, 1 zyrë zgjedhore në njësinë administrative Shkozë, 1 zyrë zgjedhore në
njësinë administrative Sukth dhe Maminas, 3 zyra zgjedhore në njësinë administrative
Katund i Ri, Rrashbull dhe Manes.
- 2 zyra zgjedhore në bashkinë Lushnje nga të cilat 1 në njësinë administrative Lushnje
Rajoni 2 dhe 1 në Lushnje qendër.
- 3 zyra zgjedhore në bashkinë Rrogozhinë nga të cilat 1 zyrë zgjedhore në lagjen nr. 1,
1 zyrë zgjedhore në rrugën Çamëria ose Gosë e Madhe dhe 1 zyrë zgjedhore në hyrje
të fshatit Kryevidh.
- 2 zyra zgjedhore në bashkinë Vorë nga të cilat 1 zyrë zgjedhore pranë ish bashkisë së
vjetër dhe 1 zyrë zgjedhore në Bërçullë.
- 2 zyra zgjedhore në bashkinë Dibër nga të cilat 1 zyrë zgjedhore në Peshkopi dhe 1 në
Maqellar.

Në raportet e dorëzuara në KQZ nuk rezultoi e deklaruar asnjë zyrë zgjedhore duke qenë se
nuk janë dorëzuar raportet e kandidatëve.

Mbi shpenzimet për mediat sociale partia “Demokratike e Shqipërisë” ka deklaruar se nuk ka
pasur shpenzime, por nga verifikimet e bëra në historikun e mediave sociale (facebook)
rezulton se:

- Kandidati i Lushnjës ka shpenzuar 7 596 (shtatë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë;
- Kandidati i Durrësit ka shpenzuar 98 102 (nëntëdhjetë e tetë mijë e njëqind e dy) lekë;
- Kandidati i Shkodrës ka shpenzuar 83 668 (tetëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë
e tetë) lekë.

Në total për mediat sociale nga kandidatët për kryetar bashkie të Partisë Demokratike e
Shqipërisë janë shpenzuar 189 366 (njëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e treqind e gjashtëdhjetë
e gjashtë) lekë.

Për sa më sipër referuar nenit 23/4, pika 3, të ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000 “Për Partitë Politike”, i ndryshuar, “Refuzimi për të bërë transparent burimet e financimit të partisë politike apo për të lejuar ushtrimin e kontrollit nga ana e ekspertit kontabël të licencuar a të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, dënohet me gjobë nga 2.000.000 deri në 5.000.000 lekë ose/dhe me pezullimin deri në 5 vjet të financimit publik për partinë politike.

III. Raportet financiare të dorëzuara në përputhje me ligjin dhe aktet nënligjore

Nga shqyrtimi i raporteve, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve konstaton se 4 (katër) parti politike i kanë dorëzuar raportet në përputhje me nenin 92/3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe vendimit nr. 9, datë 29.1.2022, të Komisionit Rregullator, “Për përcaktimin e rregullave për raportimin financiar të partive politike/subjekteve zgjedhore, kontrollin dhe verifikimin e financimeve dhe shpenzimeve të tyre gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”, si më poshtë vijon:

Partia Socialiste e Shqipërisë;

1. Partia Lëvizja e Re
2. Partia Lëvizja Socialiste për Integrim,
3. Partia Demokristiane e Shqipërisë

III.1 Raporte financiare të dorëzuara jo në përputhje me ligjin dhe aktet nënligjore

Nga shqyrtimi i raporteve, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve konstaton se 1 (një) parti politike nuk e ka dorëzuar raportin financiar në përputhje me nenin 92/3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe vendimin nr. 9, datë 29.1.2022, të Komisionit Rregullator, “Për përcaktimin e rregullave për raportimin financiar të partive politike/subjekteve zgjedhore, kontrollin dhe verifikimin e financimeve dhe shpenzimeve të tyre gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”.

“Partia Demokratike” ka dorëzuar raportin financiar për fushatën zgjedhore jashtë afatit të përcaktuar në nenin 92/3, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe nuk ka dorëzuar raportet për 5 (pesë) kandidatë për Kryetar Bashkie duke mos respektuar vendimin nr. 9, datë 29.1.2022, të Komisionit Rregullator dhe për këtë arsye nuk janë audituar raportet e kandidatëve. Referuar nenit 173, pika 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, “...Paraqitja e raporteve në shkelje të rregullave dhe formateve

të standardizuara të miratuara nga KQZ-ja dënohet me gjobë në vlerën 500.000 (pesëqind mijë) deri 1 000 000 (një milion) lekë”.

IV. Verifikimi i shpenzimeve të fushatës zgjedhore në media

Referuar nenit 92/3 të Kodit Zgjedhor si dhe vendimit nr. 9, datë 29.1.2022, të Komisionit Rregullator, “Për përcaktimin e rregullave për raportimin financiar të partive politike/subjekteve zgjedhore, kontrollin dhe verifikimin e financimeve dhe shpenzimeve të tyre gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”, subjektet zgjedhore kanë detyrimin e deklarimit të shpenzimeve për fushatë zgjedhore, përfshirë edhe shpenzimet për reklama politike. Fushata zgjedhore zhvillohet në media sipas kushteve dhe kritereve parashikuara në ligj.

Partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhje kanë deklaruar shpenzime për reklama politike nga Ofruesit e Shërbimit Mediatik Audioviziv (OSHMA) si më poshtë vijon:

1. Partia Lëvizja Socialiste për Integrim, ka deklaruar shpenzime reklamash politike në:
 - I. Televizionin Syri TV në vlerën 5.003.936 lekë,
 - II. Televizionin Kombëtar Klan në vlerën 1.170.379 lekë,
 - III. Televizioni Apollon TV në vlerën 20.000 lekë.
2. Partia Socialiste e Shqipërisë ka deklaruar 0 shpenzime për reklama politike.
3. Partia Demokratike ka deklaruar 0 shpenzime për reklama politike.

IV.1 Verifikimi paraprak

Referuar nenit 84 të Kodit Zgjedhor, fushata zgjedhore zhvillohet në media sipas kushteve dhe kritereve të parashikuara në ligj. Vendimi nr. 9, datë 29.1.2022, i Komisionit Rregullator, “Për përcaktimin e rregullave për raportimin financiar të partive politike/subjekteve zgjedhore, kontrollin dhe verifikimin e financimeve dhe shpenzimeve të tyre gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”, përcakton detyrimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për të verifikuar dhe kontrolluar respektimin e dispozitave të Kodit Zgjedhor dhe akteve të nxjerra në zbatim të tij për fondet e përfituara dhe të shpenzuara nga subjektet zgjedhore.

Pikat 5 dhe 8 të nenit 84 të Kodit Zgjedhor normojnë kohën e lejuar të transmetimit të “reklamave politike” gjatë fushatës zgjedhore. Koha e përgjithshme e transmetimit të reklamave politike gjatë gjithë fushatës zgjedhore nga secila radio dhe televizion privat nuk mund të jetë më shumë se 90 minuta për secilën parti të regjistruar për zgjedhje. Operatorët

radiotelevizivë në çdo rast zbatojnë tarifa të njëjta brenda të njëjtit segment kohor përgjatë gjithë kohës së fushatës.

Operatorët radiotelevizivë detyrohen të dorëzojnë 5 ditë përpara fillimit të fushatës tarifën për çdo segment kohor pranë KQZ-së. KQZ-ja i publikon tarifën në faqen elektronike zyrtare.

Referuar pikës 8 të nenit 84, të Kodit Zgjedhor, reklamën për kandidatët për kryetar të njësive të qeverisjes vendore llogariten në kohën e subjektit politik që ata përfaqësojnë.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve administroi tarifën zyrtare të dorëzuara nga OSHMA-të, raportet financiare të dorëzuara nga vetë partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhje, raportet e audituesve ligjorë, si dhe raportet e dorëzuara nga Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA). AMA monitoroi OSHMA-të për transmetimin e reklamave politike për periudhën 19 Shkurt 2022 – 05 Mars 2022.

Në tabelën e mëposhtme janë të ilustruara përllogaritjet lidhur me vlerën e deklaruar nga vetë subjektet zgjedhore përkthyer në minuta si dhe minutat e raportuara nga AMA përllogaritur në vlerë monetare, nga ku rezultoi se:

- Partia Lëvizja Socialiste për Integrim ka diferencë të pa deklaruar minutash transmetimi reklamash si më poshtë:

OSHMA-të	Minutat e paguara të përllogaritura bazuar në raportet e dorëzuara nga vet subjekti zgjedhor	Minutat e raportuara nga AMA	Diferenca (minuta të papaguara)
Klan Plus	0	38.67	38.67
Top Channel	0	28.85	28.85
Klan News	0	29.03	29.03
Klan Tv	8.9	41.52	32.62
Syri Tv	80.40	113.59	33.19

- Partia Demokratike ka diferencë të pa deklaruar minutash transmetimi reklamash si më poshtë:

OSHMA-të	Minutat e paguara të përllogaritura bazuar në raportet e dorëzuara nga vet subjekti zgjedhor	Minutat e raportuara nga AMA	Diferenca (minuta të papaguara)
News 24	0	26.64	26.64

Star Plus	0	115.95	115.95
-----------	----------	---------------	---------------

- Partia Socialiste e Shqipërisë ka diferencë të pa deklaruar minutash transmetimi reklamash si më poshtë:

OSHMA-të	Minutat e paguara të përlogaritura bazuar në raportet e dorëzuara nga vet subjekti zgjedhor	Minutat e raportuara nga AMA	Diferenca (minuta të papaguara)
Star Plus	0	148.48	148.48

Nga përlogaritjet e minutave vihet re se:

- Ka diferenca për disa parti politike, midis deklarimit të bërë për reklamë politike në raportin financiar dhe minutave të transmetuara, përlogaritur nga KQZ-ja.
- Disa OSHMA nuk kanë respektuar detyrimin e kohës së përgjithshme të transmetimit të reklamave politike, e cila nuk duhet të kalojë me shumë se 90 minuta gjatë gjithë fushatës zgjedhore.

Partitë politike kanë raportuar shpenzimet për reklama politike në vlerë monetare. Tarifat zyrtare të dorëzuara nga disa OSHMA janë në vlerë monetare për minutë ose sekondë. Raportet e vëna në dispozicion nga AMA janë në minuta. Gjatë përlogaritjes në minuta të transmetimit të reklamave, është bërë edhe përlogaritje e diferencës në vlerë monetare midis të dhënave të raportuara. Bazuar në llogaritjet e mësipërme rezultoi se ka diferenca në deklarime. Këto diferenca konvertohen në vlera monetare, si vijon:

- Partia Socialiste e Shqipërisë:
 - I. Televizioni Star Plus vlerën 1.737.216 lekë.
- Partia Demokratike”
 - I. Televizioni Star Plus vlerën 1.356.615 lekë,
 - II. Televizioni News 24 vlerën 3.896.100 lekë.
- Partia Lëvizja Socialiste për Integrim:
 - I. Televizioni Syri Tv vlerën 2.064.997 lekë,
 - II. Televizioni Kombëtar Klan vlerën 4.289.501 lekë,
 - III. Televizioni Klan News vlerën 1.364.410 lekë,
 - IV. Televizioni Top Channel vlerën 9.573.584 lekë,
 - V. Televizioni Klan Plus vlerën 1.997.692 lekë.

IV.2 Verifikimi i mëtejshëm me partitë politike

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në muajin Shkurt 2023, u kërkoi partive politike pjesëmarrëse në zgjedhje, shpjegime mbi shpenzimet për reklamat ne media. Shkresa ju dërgua partive politike si më poshtë vijon:

1. Partia Socialiste e Shqipërisë,
2. Partia Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI), **sot Partia e Lirisë (PL)**
3. Partia Demokratike.

Subjekti zgjedhor **“Partia Socialiste e Shqipërisë”** ka kthyer përgjigje duke na informuar se nuk ka kontraktuar asnjë shërbim për reklama politike në asnjë televizion. Rrjedhimisht nuk ka asnjë kontratë, faturë apo dokument tjetër mes palëve dhe për këtë arsye deklarimi në raportin financiar është 0.

Subjekti zgjedhor **“Partia Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI)”, sot Partia e Lirisë (PL)**, ka kthyer përgjigje duke na sqaruar se Lëvizja Socialiste për Integrim ka marrë pjesë në zgjedhjet e pjesshme vendore, të datës 6 Mars 2022, si pjesë e koalicionit **“Shtëpia e Lirisë”** në bazë të marrëveshjes së dt. 31.01.2022 me Partinë Demokratike përfaqësuar nga Komisioni i Rithemelimit dhe Partia Demokristiane. Kandidatët për 6 bashkitë janë propozuar nga Partia Demokratike përfaqësuar nga Komisioni i Rithemelimit. Partia Lëvizja Socialiste për Integrim në bazë të zbatimit të Kodit Zgjedhor ka dorëzuar raportin financiar për zgjedhjet e pjesshme vendore, të datës 6 Mars, së bashku me raportet e kandidatëve si parti udhëheqëse e koalicionit. Ju informojmë se shpenzimet për reklama televizive janë kryer nga kandidatët në mënyrë individuale dhe këto shpenzime janë të pasqyruara në raportet financiare të çdo kandidati. Raportet financiare të shoqëruara me dokumentat përkatëse janë dorëzuar në KQZ.

Lëvizja Socialiste për Integrim ka zbatuar nenin 90, pika 4 të Kodit Zgjedhor **“Subjekti zgjedhor mban përgjegjësi sipas këtij ligji për shkeljen e kushteve dhe detyrimeve lidhur me financimin nga ana e kandidatëve të vet, me përjashtim të rastit kur nga hetimi administrativ vërtetohet se subjekti zgjedhor nuk ka pasur mundësi ose, me gjithë përpjekjet e bëra, nuk ka arritur dot të parandalojë ose korrigjojë shkeljen e kryer nga kandidati. Në këtë rast përgjegjësia administrative dhe penaliteti për shkeljen i ngarkohen kandidatit”**.

Gjthashtu LSI na ka vënë në dispozicion dhe korespondencën me kandidatët për kryetar bashkie.

Subjekti zgjedhor **“Partia Demokratike”** nuk ka kthyer përgjigje. Moskthimi i përgjigjes nga ana e **“Partisë Demokratike”** është në kundërshtim me nenin 92/6, pika 6, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, **“Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”**, i ndryshuar, i cili parashikon se **“...KQZ-**

ja, për zbatim të këtij neni ka të drejtë të kërkojë të dhëna, dokumente apo informacion nga subjektet zgjedhore apo persona të tretë, të cilët duhet t'i përgjigjen kërkesës së KQZ-së brenda 15 ditëve nga marrja e saj. Mosbashkëpunimi ose refuzimi për të bashkëpunuar, asgjësimi i dokumenteve, vonesat ose sjellja e papërshtatshme në procesin e verifikimit të kryer nga KQZ-ja raportohet në prokurori si vepër penale, sipas nenit 248 të Kodit Penal, si dhe ndëshkohet administrativisht prej saj në përputhje me nenin 173 të këtij ligji....” Bazuar në nenin 173, pika 8, i Kodit Zgjedhor, mosbashkëpunimi ose refuzimi për të bashkëpunuar, asgjësimi i dokumenteve, vonesat ose sjellja e papërshtatshme gjatë procesit të verifikimit nga KQZ-ja sipas pikës 6 të nenit 92/6, ndëshkohet me gjobë në vlerën 100 000 (njëqind mijë) deri në 3 000 000 (tre milion) lekë.

IV.3 Verifikimi i mëtejshëm me OSHMA- të

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve u është drejtuar me shkresë në muajin Janar 2023, atyre televizioneve që kanë dorëzuar tarifa zyrtare sipas nenit 84, pika 5, të Kodit Zgjedhor, lidhur me mospërputhjet e evidentuara si dhe ka kërkuar informacion lidhur me kontratat që kanë lidhur me partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhje.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 463 prot., datë 28.1.2023, i është drejtuar OSHMA-ve si vijon:

- Televizionit **Klan Plus** ku i kërkohet informacion për transmetimin e reklamave politike në zgjedhjet e pjesshme vendore, të datës 6 Mars 2022 për subjektin zgjedhor “Lëvizja Socialiste për Integrim”,
- Televizionit **Top Channel** ku i kërkohet informacion për transmetimin e reklamave politike në zgjedhjet e pjesshme vendore, të datës 6 Mars 2022 për subjektin zgjedhor “Lëvizja Socialiste për Integrim”,
- Televizionit **Klan News** ku i kërkohet informacion për transmetimin e reklamave politike në zgjedhjet e pjesshme vendore, të datës 6 Mars 2022 për subjektin zgjedhor “Lëvizja Socialiste për Integrim”,
- Televizionit **Kombëtar Klan** ku i kërkohet informacion për transmetimin e reklamave politike në zgjedhjet e pjesshme vendore, të datës 6 Mars 2022 për subjektin zgjedhor “Lëvizja Socialiste për Integrim”,
- Televizionit **Syri Tv** ku i kërkohet informacion për transmetimin e reklamave politike në zgjedhjet e pjesshme vendore, të datës 6 mars 2022 për subjektin zgjedhor “Lëvizja Socialiste për Integrim”,
- Televizionit **News 24** ku i kërkohet informacion për transmetimin e reklamave politike në zgjedhjet e pjesshme vendore, të datës 6 Mars 2022 për subjektin zgjedhor “Partia Demokratike”,

- Televizionit **Star Plus** ku i kërkohet informacion për transmetimin e reklamave politike në zgjedhjet e pjeshme vendore, të datës 6 Mars 2022 për subjektin zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, si dhe për subjektin zgjedhor “Partia Demokratike”.

IV.4 OSHMA-të të cilat i janë përgjigjur KQZ-së

Në lidhje me diferencat ndërmjet minutave të reklamave politike të transmetuara nga OSHMA-të me minutat e paguara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhje (minuta të përlllogaritura nga KQZ referuar shumës së deklaruar si shpenzim për reklamë dhe tarifave zyrtare të dorëzuara nga OSHMA-të), OSHMA-të (televizionet) kanë kthyer përgjigjet si vijon:

Televizioni kombëtar **TV Klan SHA** sqaron se lidhur me diferencat që janë konstatuar nga KQZ duke llogaritur numrin e spoteve shumëzuar me çmimet zyrtare kjo është një llogaritje mekanike që nuk ka ndodhur asnjëherë në gjithë këto vite transmetimi reklamash për fushata zgjedhore. Kjo për faktin se çmimet zyrtare nuk janë aplikuar dot kurrë për asnjë lloj reklame të transmetuar. Në të gjitha rastet e kontraktimit, subjektet kërkojnë ulje dhe vijnë të përfitojnë ulje çmimi nga çmimet zyrtare. Pra si në çdo fushatë jemi detyruar t’ju bëjmë zbritje partive politike për reklamën e tyre, pas këmbënguljeve se nuk kanë buxhete t’i përballojnë çmimet zyrtare.

Televizioni **News 24** sqaron se ka transmetuar reklamë politike për subjektin “Partia Demokratike” pa pagesë duke ofruar minutazhin 45 minuta falas, sipas parashikimeve të Kodit Zgjedhor. Sa më sipër është realizuar duke menduar kohëzgjatjen e shkurtër të fushatës zgjedhore dhe impaktin për shkak se ishin zgjedhje të pjeshme. Vlen të theksohet se televizioni ka qenë i hapur të ndjekë të njëjtën rrugë me të gjitha subjektet zgjedhore që do të ofronin transmetim reklamash politike.

IV.5 OSHMA-të që nuk i janë përgjigjur KQZ-së

Në lidhje me diferencat ndërmjet minutave të reklamave politike të transmetuara nga OSHMA-të me minutat e paguara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhje (minuta të përlllogaritura nga KQZ referuar shumës së deklaruar si shpenzim për reklamë dhe tarifave zyrtare të dorëzuara nga OSHMA-të) nuk kanë kthyer përgjigje OSHMA-të (televizionet) si vijon:

- Top Channel,
- Syri TV,
- Star Plus.

OSHMA-të që nuk kanë kthyer përgjigje kërkesës së KQZ janë në kundërshtim me nenin 92/6, pika 6, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, i cili parashikon: “...KQZ-ja, për zbatim të këtij neni ka të drejtë të kërkojë të dhëna, dokumente apo informacion nga subjektet zgjedhore apo persona të tretë, të cilët duhet t’i përgjigjen kërkesës së KQZ-së brenda 15 ditëve nga marrja e saj. Mosbashkëpunimi ose refuzimi për të bashkëpunuar, asgjësimi i dokumenteve, vonesat ose sjellja e papërshtatshme në procesin e verifikimit të kryer nga

KQZ-ja raportohet në prokurori si vepër penale, sipas nenit 248 të Kodit Penal, si dhe ndëshkohet administrativisht prej saj në përputhje me nenin 173 të këtij ligji....”. Sipas nenit 173, pika 8, të Kodit Zgjedhor, “...mosbashkëpunimi ose refuzimi për të bashkëpunuar, asgjësimi i dokumenteve, vonesat ose sjellja e papërshtatshme gjatë procesit të verifikimit nga KQZ-ja sipas pikës 6 të nenit 92/6, ndëshkohet me gjobë në vlerën 100 000 (njëqind mijë) deri në 3 000 000 (tre milion) lekë...”.

IV.6 Tejkalmimi i minutazhit nga radio dhe televizione private

Neni 84, pika 5, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, përcakton kohën e përgjithshme të transmetimit të reklamave politike gjatë fushatës zgjedhore e cila nuk mund të jetë më shumë se 90 minuta për secilën parti të regjistruar në zgjedhje. Nga raportet e administruara rezulton se televizionet që kanë kaluar minutazhin e lejuar janë:

- Syri TV,
- Star Plus.

Në tabelën më poshtë paraqiten të dhënat për minutat e transmetuar nga televizionet për ato subjekte zgjedhore ku është tejkaluara koha e përgjithshme e transmetimit të lejuar.

Subjekti	Star Plus	Syri TV
PS	148,48	
PD	115,95	
Koalicioni SHL (LSI-PDK)		113,59

Transmetimi i reklamave politike tej minutazhit të përcaktuar prej 90 minutash përbën mosrespektim të detyrimeve të përcaktuara në nenin 84, pika 5 të Kodit Zgjedhor dhe ndëshkohet me gjobë sipas nenit 171, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, sipas të cilit “Shkelja e dispozitave të këtij Kodi nga anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve ose nga persona të ngarkuar me detyra, sipas këtij Kodi, kur nuk bën vepër penale, dënohet me gjobë 3 000 deri 90 000 lekë...”.

IV.7 Dorëzimin e tarifave zyrtare

Referuar nenit 84, pika 5, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, “Operatorët radiotelevizivë detyrohen të dorëzojnë 5 ditë përpara fillimit të fushatës tarifave për çdo segment kohor pranë KQZ-së. Tarifave publikohen në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve”.

IV.8 OSHMA-të që kanë dorëzuar tarifave zyrtare:

Pranë KQZ-së kanë depozituar tarifat zyrtare OSHMA-të, si më poshtë:

1. BBF Tv,
2. TV Rajonal Apollon,
3. ABC News,
4. TV Alpo,
5. Digitalb,
6. FAX News,
7. News 24,
8. Panorama,
9. TV Report,
10. TV Star Plus,
11. Syri Media Group,
12. TV Kukësi,
13. TV Scan,
14. TV Top Channel,
15. TV Klan,
16. TV Ora News,
17. TV Ora,
18. TV Vizion Plus.

IV.9 OSHMA-të private që nuk kanë dorëzuar tarifat zyrtare:

26 (njëzet e gjashtë) OSHMA nuk i kanë dorëzuar tarifat zyrtare. Në vijim paraqitet lista e operatorëve radiotelevizivë që nuk kanë dorëzuar tarifat zyrtare:

1. ADTN,
2. ABEG Tv,
3. Club Tv,
4. Era Digitalb,
5. Glob Tv,
6. One Tv Vlora,
7. Shijak Tv,
8. Tv BS,
9. Tv 6+1,
10. Tv Antena Nord,
11. Tv Berati,

12. Tv Channel 1,
13. Tv Channel 7,
14. Tv Jug,
15. Tv Klaudiana,
16. Tv Kopliku,
17. Tv Lobi,
18. Tv Mati,
19. Tv Premium Channel,
20. Tv Rozafa Motiv,
21. Tv Saranda,
22. Tv Sot 7,
23. Tv Star Plus,
24. Tv UTV Education,
25. TVT,
26. Tv Re.AL.

Nga televizionet e mësipërme kanë transmetuar reklama politike dhe nuk kanë dorëzuar tarifat zyrtare televizionet :

1. Shijak TV,
2. Tv Channel 1,
3. Tv Kopliku,
4. Tv Rozafa Motiv,
5. Tv Star Plus,

Mosdorëzimi i tarifave zyrtare përbën mosrespektim të detyrimeve të përcaktuara në nenin 84, pika 5 të Kodit Zgjedhor. Bazuar në nenin 171, pika 1 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, përcaktohet se “Shkelja e dispozitave të këtij Kodi nga anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve ose nga persona të ngarkuar me detyra, sipas këtij Kodi, kur nuk bën vepër penale, dënohet me gjobë 3 000 deri 90 000 lekë.”

V. Konstatime nga organizata (KRIIK)

Më datë 6 Tetor 2023, para zhvillimit të seancës publike organizta Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK) depozitoi nëpërmjet email-it konstatimet e

bëra për Subjektet Zgjedhore për fushatën zgjedhore të datës 6 Mars 2023 duke bërë që seanca e vendimmarrjes nga ana e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve të shtyhet.

KRIIK ka konstatuar se 2 kandidatë të subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, zj. Emirjana Sako dhe z. Edison Memolla, si dhe nga 2 kandidatë të subjektit zgjedhor “Koalicioni Shtëpia e Lirisë”, z. Ardian Muka dhe z. Bardh Spahia kanë pranuar dhurime me vlerë më të madhe se 50.000 lekë. Dhurime të cilat nuk janë bërë nëpërmjet llogarisë bankare.

KQZ, nga verifikimet e kryera pas konstatimeve të KRIIK, rezulton se kandidatët e sipërcituar kanë pranuar dhurime me vlerë më të madhe se 50 000 lekë të deklaruar në cash dhe jo nëpërmjet llogarive bankare të deklaruar në KQZ siç përcaktohet në nenin 92/2 pikat 2 dhe 3 të Kodit Zgjedhor si dhe vendimit nr. 13, datë 4.2.2022, të Komisionit Rregullator “Udhëzues për mënyrën e raportimit financiar për kandidatët për kryetarë për fushatën zgjedhore për organet e qeverisjes vendore”.

Më konkretisht:

Znj. Emirjana Sako në raportin e saj si kandidate e Partisë Socialiste i ka dhuruar vetes 92.775 lekë cash.

Z. Edison Memolla në raportin tij si kandidat i Partisë Socialiste i ka dhuruar vetes 120.590 lekë cash.

Z. Ardian Muka në raportin e tij si kandidat i Koalicionit Shtëpia e Lirisë i ka dhuruar vetës shumën 415.000 lekë cash (të ndarë në tre këste dhuruar ne 120.000 lekë, 150.000 lekë dhe 145.000 lekë).

Z. Bardh Spahia në raportin e tij si kandidat i Koalicionit Shtëpia e Lirisë i ka dhuruar vetes 91.420 lekë cash (të ndarë në dy këste 40.000 lekë dhe 51.420 lekë).

Bazuar në nenin 173, pika 5 e ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, përcaktohet se “... Pranimi i fondeve private me vlerë më të madhe se 50 mijë lekë përmes formave të tjera, të ndryshme nga kalimi në llogarinë bankare, dënohet me gjobë të barabartë me shumën e dhuruar dhe në kalimin e fondeve të marra në KQZ”.